

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
URDHRI I FARMACISTËVE  
KESHILLI KOMBETAR

## RAPORT

### Analiza e punes 2014

#### Sektori i regjistrimit dhe certifikimit te farmacisteve

Bazuar ne Rregulloren per anetaresimin e farmacisteve dhe regjistrimin e ndihmes farmacisteve gjate vitit 2014, puna ne kete sektor eshte perqendruar ne:

Dhenien e informacionit te vazhdueshem farmacisteve, lidhur me plotesimin e dokumentacionit per anetaresim ne UFSH dhe eshte asistuar per nje plotesim sa me te sakte te dokumentacionit te paraqitur.

Dokumentacioni i paraqitur nga farmacistet dhe ndihmes farmacistet pasi eshte kontrolluar per saktesine e tij eshte pranuar dhe eshte regjistruar ne protokollin perkates.

Per anetaresimet e reja ne UFSH, ne baze te dokumentacionit te paraqitur nga farmacistet eshte bere regjistrimi ne regjistrin e farmacisteve i cili, eshte dokumenti baze i evidentimit sasior dhe cilesor te te dhenave te farmacisteve.

Pasi farmacistet jane regjistruar ne regjistrin e farmacisteve, informacioni eshte hedhur ne programin informatik ne te cilin ruhet ne menyre me te plote, informacioni mbi cdo anetar ndryshimet ne vendin e tij te punes, kualifikimet, ndershkimet e ndryshme profesionale te anetareve, etj.

Pas hedhjes se te dhenave ne program, jane pergatitur Certifikatat e anetaresimit dhe jane terhequr personalisht nga farmacisti aplikues.

Dokumentacioni i farmacisteve eshte depozituar ne dosje dhe per anetaret e rinj eshte hapur dosje e re me dokumentacionin e paraqitur per anetaresim.

Deri në fund të vitit 2014 janë anëtarësuar në UFSH **2494** farmacistë, pozicionet e të cilëve janë si mëposhte:

- Drejtues teknik në farmaci
- Drejtues teknik në importues, eksportues, shpërndarës, prodhues farmaceutike
- Të punësuar farmacist në sektorin privat
- Të punësuar farmacist në sektorin shtetëror
- Të punësuar në Perfaqësi farmaceutike etj.

Gjatë vitit 2014 në UFSH, pas kryerjes me sukses të provimit të shtetit janë anëtarësuar gjithsej 315 farmacist të rinj. Gjithashtu janë anëtarësuar dhe 11 ndihmes farmacistë.

Veprimet e kryera për anëtarët e UFSH konsistojnë në anëtarësime të reja, licensime për here të pare, ndryshime të drejtuesit teknik nga një subjekt në tjetrin, ndryshime të vendit të punës të farmacistëve të punësuar. Nder këta aplikues ka patur edhe aplikime të cilat janë kthyer për plotësim të dokumentacionit të munguar dhe për mos plotësim të kriterëve për të kryer veprimet e pretenduara.

Gjatë vitit 2014 janë bërë 363 certifikime të reja për pozicionin e Drejtuesit teknik. Bazuar në keto të dhëna çdo tre muaj është përpiluar një raport i cili i është vënë në dispozicion sektorit të mbikqyerjes me qëllim përfshirjen në planin e mbikqyerjes profesionale. Gjatë këtij viti vërejmë një numër të madh Certifikatash për Drejtues teknik. Kjo për shkak të plotësimit të afatit 2 vjeçar të farmacistëve që ju nënshtuan për here të pare provimit të shtetit në sezonet Janar, Maj, Dhjetor 2012.

Si pasojë e kësaj kemi pasur dhe një numër jo të vogël farmacistësh të cilët biznesin e tyre e kanë kthyer nga Agjensi farmaceutike në Farmaci.

Gjatë pranimit të dokumentacionit për anëtarësim apo veprime të tjera që kryhen pranë këtij sektori harxhohet një kohë e konsiderueshme për saktësimin e plotësimit të

dokumentacionit nga farmacistet te cilet, ne shumicen e rasteve, kerkojne asistence teknike per plotesimin e tij.

Eshte treguar kujdes, qe rast pas rasti, gjate plotesimit te dokumentacionit te paraqitur nga farmacistet, te kerkohen edhe vetdeklarime te cilat, mund te jene baze per shtesa ne dokumentacionin per anetaresim, qe do te aprovohen nga Keshilli Kombetar ne te ardhmen.

Gjithesesi Sektori i Anetaresimit ka predispozicionin per ta permbushur me sukses misionin e tij. Te gjithe farmacistet qe do i drejtohen ketij sektori per kryerjen e veprimeve do te gjejne ndihmen maksimale .